



Nr. 2531 vep.
Nr. 674 kol.

KONTRATE SHITBLERJE E KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE

Sot ne Berat , me date 27.10.2009 , perpara meje notere Andromaqi Berati, me zyre ne lagjen „10 Korriku“ (perballe Gjykates se Rrethit) u paraqiten personalisht palet kontraktuese :

SHITESI – CAUSH QATO, i biri i Sami dhe Mine, lindur ne Corovode, Skrapar me 24.02.1977 dhe banues ne Polican, Skrapar , me zotesi te plote juridike per te vepruar , i njohur personalisht prej meje noteres, mbajtes i Pasaportes numer Z2165292.

BLERESI- NIKO METIKOS, i biri i Thoma dhe Lefterije, lindur ne Brozdovec, Korce me 01.01.1979 dhe banues ne Polican, Skrapar, me zotesi te plote juridike per te vepruar , i panjohur prej meje , i identifikuar konform Leternjoftimit Id numer 025201884.

... te cilet kerkuan redaktimin dhe legalizimin e kontrates se shitjes se kapitalit themeltar te shoqerise si me poshte vijon :

Shitesi Caush Qato eshte Ortak i Vetem i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar „GERI 01“ shpk, regjistruar me Vendimin numer 30503 date 04.11.2003 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ndryshuar me Vendimin numer 30503/1 date 11.01.2005 me seli ne Polican, Skrapar, duke qene keshtu pronar i 100% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise i cili perbehet nga 100 kuota ose 100.000 leke (vlere nominale e nje kuote eshte 1000 leke) . ---

Shitesi Caush Qato, deklarone nen pergjegjesine e tij personale dhe me vullnetin e tij te lire se teresisht kapitalin themeltar te shoqerise „GERI 01“ shpk prej 100 kuotash ia shet bleresit Niko Metikos kundrejt cmimit 100.000 leke duke shprehur deshiren dhe vullnetin e tij qe ky te jete pronari i ri, i vetem , i ligjshem i shoqerise se siperpermendur .-----

Nga ana e tij bleresi Niko Metikos , deklarone se ble nga shitesi Caush Qato 100% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise „GERI 01“ shpk (gjithsej 100 kuota) kundrejt cmimit 2100.000 (njqindmije) leke.-----

Palet deklarojne se cmimi i shitblerjes prej 100.000 leke eshte likujduar mes tyre jashte kesaj zyre noteriale.-----

Keshtu, me nenshkrimin e kesaj kontrate shitblerje, Caush Qato humbet pronesine mbi teresisht kapitalin themeltar te shoqerise ndersa Niko Metikos behet Ortak i Ri, i Vetem, pronar i 100% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise „GERI 01“ shpk.

Kontrata , e cila u perpilua ne kater kopje me vlere te njejte, si u lexua dhe u pa se ishte e njejte me vullnetin e lire te paleve, u nenshkrua rregullisht prej tyre. Une noterja e vertetoj ate.

SHITESI

Caush Qato

BLERESI

NIKO METIKOS

NOTERE

Andromaqi BERATI